

Ligjëratat e Skenarit bazuar edhe
në librin

LUIS HERMAN

**SKENARI PËR FILM DHE
TELEVIZION**

Java - I

Baza historike e skenarit

Skenari

Dikur nuk kanë qenë të nevojshme këto dije dhe njohuri të veçanta rreth xhirimit të filmit. Derisa filmi ishte në zanafillën e tij, xhiruesi ka qenë çdo gjë – ai që sajoi rrëfimin, pra skenarist, regjisor dhe montazhier njëkohësisht. Pikërisht çdo gjë!

Me kalimin e kohës kërkesa e tregut për filma rritet vazhdimisht e bashkë me këtë edhe puna e xhiruesit të filmit bëhet gjithnjë e më rëndë, kështu që ai detyrohet që një pjesë të kompetencave të tij t'ua kalojë njerëzve të tjerë. Megjithatë, edhe për një kohë mbetet detyrë e tij që të ndjekë rrjedhën e rrëfimit, sepse askush nuk konsideronte se është e nevojshme të shkruhet skenari për film. Atëbotë, filmat xhiroheshin sipas përmbajtjeve që sajoheshin aty për aty.

Një hap tjetër u bë atëherë, kur u fillua të thirreshin shkrimtarë të vodëvilëve që për kameramanët të shkruanin disa situata komike, kurse ai pastaj i xhironte ato. Pak kohë më vonë, nga kameramani u kërkua që të shkruante edhe ato copa

tekstesh, të cilat te filmi pa zë shërbenin si zëvendësim i dialogut ose si komente përshkruese. Shumica e këtyre teksteve ishin të natyrës „zbardhi dita“. Kurse më vonë, kur filmi zuri të zhvillohej në pikëpamje të ideve dhe të rritej në gjatësi, skicat për xhirim zunë të bëheshin më të gjata dhe gjithnjë më të komplikuar. Ndodhi kështu ndarja e specialiteteve brenda punës për hartimin e skenarëve: disa jepnin bazën e rrëfimit, të tjerët përpunonin situatat, specialistë të veçantë shkruanin tekstet e titllave që shërbenin si përmbledhje e dialogut ose shërbenin si shpjegim, **kurse njëri dhe vetëm njëri i bashkonte të gjitha ato dhe bënte skenarin.**

Me futjen e zërit dhe të dialogut në film, hartuesi i titllave automatikisht bëhet i panevojshëm. Por tani rritet kërkesa për shkrimtarë dialogësh. Në fillim ata vinin nga radhët e dramaturgëve të Brodueit. Në atë kohë, kur filmi pa zë u zëvendësua me filmin tonik, nga teatrot u morën profesionalistët e të gjitha fushave – që nga aktorët dhe regjisorët e deri te hartuesit e dialogëve. Por që filmat e parë me zë dëshmuuan se sa është e gabueshme predispozita që një medium kryesisht statik të bartet në botën e lëvizjes, siç është filmi. Ishin këto pjesë teatrore të bartura thjeshtë në ekranin filmik.

Gabimin kryesor e bënin skenaristët, sepse nuk kishin ndërmarrë asgjë, në mënyrë që shkrimin e tyre për teatër t’ia përshtatnin një mediumi të ri, që ishte filmi. Dialogët ishin patetikë dhe tepër të gjatë. Disa skena të veçanta ngadalësonin trimin. Planin e gjerë e zëvendëson plani i mesëm dhe mizanskena në total.

Megjithatë, pak nga pak, meqë krijuesit e filmave i hetuan gabimet, niveli i shkrimit të skenarëve pësoi një ngritje. Dialogët e gjata domosdoshmërisht bëhen më të shkurtër dhe sot mund të thuhet se, në shumicën e rasteve, ata janë përmbajtjesorë dhe realistë. U hetua se totali e ka një rol të rëndësishëm në film, por jo në dëm të armës më të fortë të filmit – planit të gjerë. Ana teknike e shkrimit të skenarit gjithashtu përparoi dukshëm, kështu që prej tyre lindën filma që kanë temp të tillë që i pikërisht i duhet filmit.